

2021

Përmbledhje Jo-Teknike “ENERGIA B” shpk

Zhvilluesi: “ENERGIA B” SHPK

Projekti: "Furnizim me karburant i makinave ne nje stacion te furnizimit me karburant ne zonat urbane"

Shoqëria:

ENERGIA B sh.p.k

Përgatitur nga:



GUSHT, 2021

Contents

1. HYRJE.....	0
2. KUSHTET EKZISTUESE.....	0
3. PËRSHKRIM I SHKURTER I AKTIVITETIT	1
4. TRANSPORTI I BRENDSHEM DHE NDERLIDHJA	3
5. LENDA E PARE E PERDORUR	3
6. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS.....	3
7. TEKNIKAT MË TË MIRA TË DISPONUESHME	5
8. MASAT NDAJ ZJARRIT.....	6

1. HYRJJE

Shoqëria ENERGIA B sh.p.k synon zhvillimin e aplikimit për leje mjedisi të tipit B si rrjedhojë e rinovimit të lejes ekzistuese C (PN-0864-09-2015) që shoqëria disponon dhe me të cilën shoqëria ka operuar.

Referuar Ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” i ndryshuar dhe fakti që objekti ku kërkohet të zhvillohet aktiviteti është ekzistues dhe i pajisur me leje mjedisi të mjedisit tipi C, me nr identifikimi 360, date 21.09.2015, për veprimtarinë “ID, 1.10, Furnizimi me karburant i makinave ne nje stacion te furnizimit me karburant” dhe bazuar në Ligjin Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, shtojca 1, Lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C në varësi të kapacitetit prodhues kufi, operatori “ENERGIA B” sh.p.k do të aplikojë pranë QKB-së për pajisjen me leje te re mjedisore me kodin:

- **Industrite energjitike, ID 1.10, “Furnizim me karburant i makinave ne nje stacion te furnizimit me karburant ne zonat urbane”**

2. KUSHTET EKZISTUESE

Shoqëria Energia B shpk është një shoqëri tregtare e krijuar si person juridik në bazë të vendimit të gjykatës nr. 29523, date 16.04.2003, kryesisht në:

- Shërbime profesionale teknike ne fushen e ndertimit dhe te mirembajtjes se rrjeteve te telefonise celulare, sherbime teknike ne pajisje gjeneratore, elektrike dhe elektronike etj.

Në kuadër të këtyre aktiviteteve Shoqëria ENERGIA B SHPK kryen dhe aktivitetin e tregtimit të karburantit me pakice (kjo vetem për përdorim të nevojave që vete shoqëria ka). Ky aktivitet është kryer deri tani në bazë të lejes mjedisore (Tipi C) të përshkruar më lartë.

Vendndodhja e pikes se karburantit me aktivitet: Veprimtarinë “ID, 1.10, Furnizimi me karburant i makinave ne nje stacion te furnizimit me karburant ne zona urbane ” i cili ndodhet Tiranë, Kashar KASHAR, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 6, Objekti DIEKAT, Kashar, Tiranë. Ky objekt është në pronësi të Shoqërisë “Energia B” shpk.

3. PËRSHKRIM I SHKURTER I AKTIVITETIT

Skema e perpunimit teknologjik te pikes se furnizimit me pakice te karburanteve eshte zgjedhur duke shfrytezuar te dhenat e kompanise “ENERGIA B”. Zgjidhja teknologjike ne kete rast eshte e thjeshte, elastike dhe shume funksionale. Rezervuari i karburantit ka kapacitet 7.84 m³, kjo e vertetuar dhe sipas “Vertetimit per matje vellimi”, me Nr Prot 1668, date 27.04.2015 dhe vertetimit teknik me Nr. 111/1 Prot. Date 20.04.2021. Rezervuari eshte futur nen toke dhe pompa eshte ne siperfaqe. Pompa ka pistoleta te kalibruara nga Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise.

Sipas pasqyres 11 a, te “AKT KONSTATIM NE VERIFIKIM NE PIKAT E TREGETIMIT TE KARBURANTEVE”, Nr i serise per Pis I dhe Pis II:0919397091A dhe Nr vule per Pis I:0815 dhe Pis II:0836.

Rezervuari ka linje te vecante te ajrimit dhe te furnzimit te tij nga autocisterna. Tubat e perdorur per keto linja jane prej celiku te zinguar.





4. TRANSPORTI I BRENDSEHEM DHE NDERLIDHJA

Kompozimi i objektit është bërë duke konsideruar fillimisht skemën e lidhjes teknologjike të aparaturave në pikën e furnizimit me karburant, si dhe mundësitë e dhëna nga sheshi i parashikuar.

Mbi këto synime është realizuar shtrija në plan dhe në lartësi të objektit.

Në kompozimin e plote të objektit është pasur parasysh edhe manipulimi sa më i përshtatshëm i automjeteve që do të furnizohen me karburant.

Rezervuari i karburantit të kompanisë “ENERGIA B” ka kapacitet 7840 litra.

Rezervuari është i futur nën tokë dhe dy pompat janë jashtë.

Secila pompe ka dy pistoleta të kalibruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë.

Rezervuari ka linje të veçanta të ajrimit dhe të furzinimit të tij nga autocisterna.

Tubat e përdorur për këto linja janë prej çeliku të zinguar.

Për vetë karakterin teknologjik të këtij loji dhe rrezikshmerinë që paraqesin ato, është parashikuar edhe mbrojtja e pajisjeve nga rena nëntension dhe nga shkarkimet atmosferike.

5. LENDA E PARE E PËRDORUR

Lenda e parë që do të përdoret në këto aktivitete, janë vetë hidrokarburet që do të mbahen në cisternen nëntokesore, dhe që do të shërbejnë për rimbushje të makinerive të shoqërisë.

ENERGIA B furnizohet me hidrokarbure nga kompania, “GENKLAUDIS” SHA, me të cilën kanë dhe kontratë furnizimi/bashkëpunimi.

6. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Përshkrimi i shkurtër i zonës

Objekti është i vendosur në zonën periferike të Tiranës, përgjatë autostradës Tiranë-Durrës. Kjo zonë është një zonë me aktivitete industriale ku në të dyja anët e autostradës ka objekte të shumta që ushtrojnë aktivitetin e tyre tregtar ose prodhues. Zona ndodhet në përfundim të qytetit

të Tiranës, në Kashar, Kilometri i 6 i autostradës Tiranë-Durrës. Për shkak të zhvillimit të aktivitetit industrial në këtë zonë sikurse dhe nga vetë natyra e aktivitetit të subjektit, zhvillimi i tij nga ENERGIA B nuk konsiderohet si aktivitet me ndikime në zonën përreth.

Airi

Aktiviteti i subjektit është vetëm furnizimi me pakice për mjetet e kompanise me karburant dhe për këtë arsye nuk ka shkarkim të ndotësve në ajër. Ndotja në ajër konsiderohet e papërfillshme, tepër minimale dhe e kufizuar në kohë pasi sistemi i instalimit dhe teknologjia e përzgjedhur minimizon në maksimum emetimin e aromave dhe rrjedhjet e gazeve në atmosferë.

Ujërat

Në përgjithësi nga vetë natyra e aktivitetit të subjektit nuk ka shkarkime ujore apo ndotje pasi aktiviteti është i kufizuar. Në rast derdhjesh aksidentale të hidrokarbureve në sipërfaqe përsëri nuk parashikohet ndotje pasi sipërfaqja është e shtruar me beton dhe si rrjedhojë është i pamundur infiltrimi i hidrokarbureve në ujërat nëntokësore. Ndotja e ujit konsiderohet e papërfillshme.

Zhurmat

Aktiviteti i punës është i tillë që nuk ka burime fikse të zhurmës, duke qenë se procesi i punës përfshin vetëm furnizimin. Gjithsesi si impakt zhurma mund të vijë nga levizja e mjeteve.

Flora dhe fauna

Nuk parashikohen ndikime në bimësi duke përmendur lloje endemike, lloje me status të veçantë, habitate me vlera, ekosisteme funksionale etj. Zona nuk ka vlera të veçanta floristike megjithatë zona e subjektit për ushtrimin e aktivitetit është e kufizuar në një sipërfaqe jo të madhe. Gjithashtu edhe për faunën e zonës, lidhur me specie me status të veçantë dhe të mbrojtura, theksohet se specie të tilla nuk janë prezente në zonën e aktivitetit. Përreth zonës mund të hasen vetëm shpende të qytetit.

Ndotja e tokës

Ujërat e ndotura nga tualetet dhe larja e ambienteve të ushtrimit të aktivitetit shkarkohen në sistemin e kanalizimit të ujërave të ndotura. Njësoj edhe për ujërat e shiut. Mbetjet e gjeneruara gjatë ditës së punës grumbullohen në koshat përkatës nga punonjësit e magazinës dhe më pas largohen për në vendndodhjen e grumbullimit të mbetjeve nga Bashkia. Nuk parashikohen ndikime negative në tokë nga ushtrimi i aktivitetit.

Rastet aksidentale

Zbatimi i aktivitetit të subjektit vlerësohet se nuk do të sjell rrezikshmëri për aksidente. Në rast zjarri automjetet zjarrfikëse mund të afrohen dhe të veprojnë për shuarjen e tij pa pengesë dhe në mënyrë efektive. Objekti plotëson të gjitha kërkesat teknike dhe urbanistike për të kryer një aktivitet të tillë. Gjithashtu mbajtja e fikësve të zjarrit në objekt është e nevojshme, në rastet e ndërhyrjes ndaj zjarrit. Janë marr masat për parandalimin e rasteve aksidentale, mjetet kontrollohen vazhdimisht për gjendjen teknike të tyre në mënyrë që të mos kemi rrjedhje lubrifikanti apo karburant. Shoqëria siguron se do ketë ndërhyrje të menjëhershme nëse do të ketë ndikim negative në mjedis.

Burimet e shkarkimeve nga instalimi

Nga aktiviteti i furnizimit me karburant nuk ka burime emetimi, pasi nafta në territorin e karburantit, vjen e mbyllur dhe e izoluar. Parashikohet që gjatë transportit të cisternes me naftë, nga makinerite të transportit të këtyre emetimeve të lehta (pluhura, gaze), si dhe gjenerim të vogël të zhurmave.

Monumente, trashëgimi, vepra

Nuk ka vlerë trashëgimore zona e ushtrimit të aktivitetit. Lidhur me peisazhin, inxhinieret janë kujdesur gjatë fazës së projektimit për anën estetike të projektit dhe hapësira të gjelbëruara.

7. TEKNIKAT MË TË MIRA TË DISPONUESHME

- Shoqëria ENERGIA B Shpk, zbaton teknikat më të mira të disponueshme për të minimizuar ndotjet. Duke patur parasysh aktivitetin e kompanisë, përmendim këtu: kontrollin periodik dhe inspektimin për incidente të mundshme gjatë transportit apo magazinimit të naftës, spërkatjen me ujë të territorit përreth cisternes në kohë të thate, uljen e shpejtësisë së makinerive, trajnimin e punonjësve etj.
- Marrjen e menjëhershme të masave në rast ndotjesh (incidente me derdhjet e karburanteve, vajrash nga makinerite) si dhe monitorim të vazhdueshëm.
- Në përputhje me ligjin e intergruar të mbetjeve, kompania ka parim minimizimin e mbetjeve, ripërdorimin dhe në fund asgjësimin e tyre.
- Kompania ka marrë masa për të parandaluar perditjen e energjisë: fikja e makinerive/pajisjeve kur nuk është e nevojshme që të punojnë, shfrytëzimi i dritës natyrore.
- Subjekti kryen kontrollin dhe mirëmbajtjen periodike të makinerive, duke minimizuar kështu avaritë dhe ndotjet që mund të vijnë si pasojë. Gjithashtu subjekti ka pajisur makinerite të rënda me kutinë përthithëse (spill-kit) në rast incidenti për të parandaluar perditjen e lëndës së rënda.

incidenteve me karburant si dhe ka bere trajnimin e duhur te punonjesve ne lidhje me nderhyrjen dhe perdorimin e kutise se incidenteve.

- Paralelisht me funksionimin, subjekti gjithashtu do te kujdeset dhe per rehabilitimin e mjedisit, ne menyre qe te minimizohet impakti negativ fillestar ne peisazh. Subjekti mer persiper sigurimin e ecurise normale te punes dhe ruajtjen e vazhdueshme te mjedisit deri ne mbylljen e aktivitetit.

Kompania ENERGIA B, ka kontrate sherbimi per mirembajtjen e depozitave te naftes si dhe per pastrimin e tyre me kompanine “Petrol Teknika” Shpk.

8. MASAT NDAJ ZJARRIT

Rreziku ndaj zjarrit është prezent në të gjitha mjediset. Për të ulur shkallën e rrezikut ndaj zjarrit dhe sigurimin e mbrojtjes së personave, nga ana e shoqërisë janë marre masat ndaj mbrojtjes së zjarrit. Hidrantet janë vendosur në zona të dukshme brenda siperfaqes së magazines dhe punonjësit janë instruktuar për përdorimin e tyre në raste aksidentesh.

Punëdhënësi pas vlerësimit të rreziqeve të zjarrit dhe në bazë të planit të emergjencës, ka përcaktuar punëtorët përgjegjës për zbatimin e masave të parandalimit të zjarrit, rastet e nderhyrjes, dhe menaxhimin e emergjencave. Detyra e përgjegjësimit është, jo vetëm të sigurojë që puna të kryhet në bazë të programit, por edhe që ajo të kryhet në kushte sigurie, duke respektuar masat e vëna në dispozicion nga eprorët, rregullat mbi kujdesin në punë, si dhe që punëtorët të respektojnë standartet dhe të përdorin, nëse nevojitet, pajisje personale mbrojtëse si dhe të kontrollojnë funksionimin e tyre. Në rast zjarri behet aktivizim I menjëhershëm i stafit dhe mjeteve të fikjes së zjarrit si dhe njoftim i menjëhershëm I autoriteteve dhe njërive të specializuara në rast emergjencash (zjarrfikëse, autoambulanca).